

Broshurë teknike

EPOMAX-STUCCO

Stuko epokside me 2 përbërës, me kokrriza jashtëzakonisht të imëta

Përshkrimi

EPOMAX-STUCCO është një sistem epoksid me 2 përbërës dhe pa tretës, i cili ofron ngjitje shumë të fortë me nënshtresën, fortësi të lartë dhe rezistencë të lartë mekanike. Është jashtëzakonisht rezistent ndaj substancave acide, alkaline, ndaj detergjenteve, ujit të detit dhe ndaj luhatjeve të temperaturave.

I certifikuar në përputhje me EN 1504-4 dhe i klasifikuar si një agjent lidhës strukturor për llaç ose beton. Certifikata Nr. 2032-CPR-10.11.

Fushat e përdorimit

EPOMAX-STUCCO është ideale për stukimin e sipërfaqeve. Përdoret gjithashtu për ngjitjen e betonit, të hekurit, gurit, drurit etj., për meremetimin e dëmtimeve në beton dhe në shtresa me llaç çimentoje, si dhe për izolimin e plasaritjeve që do të meremethen rrëshirat epokside të injektueshme EPOMAX-L10, EPOMAX-L20 ose DUREBOND.

Të dhënat teknike

Baza:	rrëshirë epokside me 2 përbërës
Ngjyra e përbërësit A:	e bardhë
Ngjyra e përbërësit B:	gri
Ngjyra A+B:	gri
Trajta:	në formë brumi
Densiteti i përbërësit A:	1,53 ± 0,07 kg/l
Densiteti i përbërësit B:	1,50 ± 0,20 kg/l
Densiteti A+B:	1,52 ± 0,14 kg/l
Raporti i përzierjes (A+B):	100:100 sipas peshës
Koha e punueshmërisë:	rreth 60 min (+20°C)
Temperatura minimale e mpiksjes:	+8°C
Koha e shkeljes:	pas 16 orësh (+23°C)
Fortësia finale:	pas 7 ditësh (+23°C)

Ngjitja e betonit të ngurtësuar me betonin e ngurtësuar dhe ajo e betonit të freskët me betonin e ngurtësuar (EN 12636):

kalon (thyerje në beton)

Forca ngjitëse në prerje për betonin e ngurtësuar me betonin e ngurtësuar: (EN 12615)

7,8 N/mm²

Rezistenca në shtypje: (EN 12190)

≥ 50,0 N/mm²

Tkurra: (EN 12671-1)

0,05%

Punueshmëria: (EN ISO 9514)

60 minuta në +20°C

Ndjeshmëria ndaj ujit: (EN 12636)

O₂

Moduli i elasticitetit në shtypje: (EN 13412)

5.150 N/mm²

Koeficienti i bymimit termik: (EN 1770)

61 X 10⁻⁶

Temperatura e tranzicionit të qelqit: (EN 12614)

≥ 74°C

Reagimi ndaj zjarrit: (EN 13501-1)

Euroclass E

Qëndrueshmëria: (EN 13733)

kalon*

**Ngarkesa prerëse në shtypje gjatë prishjes pas ekspozimit ndaj ciklit termik nuk duhet të jetë më e vogël se rezistenca më e ulët tendosëse e betonit të lidhur ose e betonit origjinal.*

Rezistenca në përkulje: (DIN EN 196-1)

≥ 30,0 N/mm²

Pastrimi i veglave:

Veglat duhet të pastrohen menjëherë pas përdorimit me tretësin SM-25.

EPOMAX-STUCCO

Udhëzimet e përdorimit

1. Nënshtrësia

Sipërfaqja e aplikimit duhet të jetë:

- E thatë dhe e qëndrueshme.
- Pa materiale që pengojnë ngjitjen, si p.sh. pluhuri, grasoja, grimcat e lira etj.

2. Përzierja e përbërësve

Përbërësit A (rrëshira) dhe B (forcuesi) janë të paketuar në dy enë të ndara, me raport të paracaktuar të përzierjes. E gjithë sasia e përbërësit A dhe përbërësit B hidhet në një enë të pastër dhe përzihet për rreth 5 minuta duke përdorur një vegël pune të përshtatshme (p.sh. mistri e vogël), derisa të krijohet një stuko uniforme në trajtë brumi.

Në rast se nevojitet sasi më e vogël sesa ajo që disponohet në paketë, merren sasi të barabarta sipas volumit nga përbërësi A dhe përbërësi B dhe përzihen plotësisht në një enë të pastër siç përkrahëhet më lart.

3. Përdorimi - Konsumi

EPOMAX-STUCCO aplikohet me mistri ose shpatull mbi sipërfaqen e thatë dhe të pastër.

Konsumi: Rreth 1,35 kg/m²/mm të trashësisë së shtresës.

Ambalazhimi

EPOMAX-STUCCO ofrohet në paketime (A+B) prej 1 kg, ku përbërësit A dhe B kanë raport të fiksuar të peshës.

Magazinimi

Të paktën 12 muaj nga data e prodhimit nëse ruhet në paketimin origjinal të izoluar, në ambiente të mbrojtura nga lagështira dhe ekspozimi në dritën e diellit. Rekomandohet një temperaturë ruajtjeje midis +5°C dhe +35°C.

Shënime

- Punueshmëria e materialeve epokside ndikohet nga temperatura e tyre. Temperatura ideale e përdorimit është midis +15°C dhe +25°C në mënyrë që produkti të jetë i lehtë për t'u përdorur dhe për t'u tharë, ashtu siç shpjegohet më lart. Temperatura e ambientit nën +15°C do të rrisë kohën e tharjes dhe temperatura mbi +30°C do të përshpejtojë kohën e tharjes. Gjatë dimrit rekomandohet një ngrohje paraprake e produktit, kurse në verë rekomandohet ruajtja e materialit në një vend të freskët përpara përdorimit.
- Pas ngurtësimit, EPOMAX-STUCCO është plotësisht e sigurt për shëndetin.
- Përpara përdorimit, lexoni këshillat e sigurisë të treguara në etiketën e produktit.
- EPOMAX-STUCCO është synuar vetëm për përdorim profesional.

Përbërësit organikë të avullueshëm (VOC)

Sipas Direktivës 2004/42/KE (Shtojca II, tabela A), përmbajtja maksimale e lejuar e VOC-së për produktin e nënkategorisë "g", lloji SB është 350g/l (2010) për produktin e gatshëm për përdorim. Produkti i gatshëm për përdorim EPOMAX-STUCCO përmban maksimumi <350 g/l VOC.

EPOMAX-STUCCO



2032

ISOMAT S.A.

17th km Thessaloniki – Ag. Athanasios
P.O. BOX 1043, 570 03 Ag. Athanasios, Greece

10

2032-CPR-10.11

EN 1504-4

DoP No: EPOMAX-STUCCO/1264-01

Structural bonding product for bonded mortar or
concrete for uses other than low performance
requirements

Adhesion: Fracture to concrete

Shear Strength: $\geq 6.0 \text{ N/mm}^2$

Compressive strength: $\geq 30.0 \text{ N/mm}^2$

Shrinkage expansion: $\leq 0.1\%$

Workability: 60 minutes at $+20 \text{ }^\circ\text{C}$

Sensitivity to water: pass

Modulus of elasticity: $\geq 2,000 \text{ N/mm}^2$

Coefficient of thermal
expansion: $\leq 100 \times 10^{-6}$ per K

Glass transition temperature: $\geq 40 \text{ }^\circ\text{C}$

Reaction to fire: Euroclass E

Durability: Pass

Dangerous substances: comply with 5.4

ISOMAT S.A.

BUILDING CHEMICALS, MORTARS & PAINTS

SELIA NË SELANIK, GREQI

Kilometri i 17të i Autostradës Selanik - Aj. Athanasiu 570 03

T +30 2310 576 002

www.isomat.al e-mail: support@isomat.eu